


Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY
ARRU

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT NË KOSOVË NË 2025

Raport për performancën e kompanive të licencuara të furnizimit me ujë dhe furnizimit me shumicë të ujit të papërpunuar

Tetor 2026

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Vizioni

"Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë"

Misioni

"Rregullim i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik"

Përmbajtja

1. HYRJE 5

2. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU 7

3. PERFORMANCA E KOMPANIVE RAJONALE TË UJIT 8

3.1. Performanca operative - furnizimi me ujë 8

3.1.1. Cilësia e ujit 8

3.1.2. Shtypja 9

3.1.3. Vazhdimësia e furnizimit me ujë 10

3.1.4. Defektet në rrjetin e ujësjellësit 12

3.1.5. Uji i pa-faturuar 13

3.1.6. Mbulueshmëria me shërbime 14

3.2. Performanca komerciale dhe financiare - furnizimi me ujë 16

3.2.1. Matja e ujit 16

3.2.2. Ankesat 16

3.2.3. Shitjet volumetrike 17

3.2.4. Shitjet në vlerë monetare 18

3.2.5. Kostot 20

3.2.6. Investimet kapitale për ujësjellës 23

3.3. Përformanca operative - shërbimet e ujërave të ndotura 26

3.3.1. Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara 26

3.3.2. Performanca e rrjetit të kanalizimit 26

3.4. Performanca komerciale dhe financiare – shërbimet e ujërave të ndotura 28

3.4.1. Mbulueshmëria me shërbime 28

3.4.2. Ankesat 28

3.4.3. Shitjet në vlerë monetare 30

3.4.4. Vlera relative e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura 30

3.4.5. Kostot për njësi 31

3.4.6. Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura 34

3.5. Performanca financiare për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 37

3.5.1. Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave 37

3.5.2. Kthimi në kapital 38

3.5.3. Shpenzimet operative 40

3.5.4. Efikasiteti i stafit 42

4. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË – NH IBËR LEPENCI 44

SHTOJCA 1: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT 45

SHTOJCA 2: PËRMBLEDHJE TREGUESISH TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT 60

SHTOJCA 3: PASQYRAT PËRMBLEDHËSE TË ARDHURAVE TË OFRUESVE TË SHËRBIMIT 62

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Planet Rregullatore
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
PR	Kompania Rajonale e Ujit Prishtina (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujit Hidroregjioni Jugor (Prizren)
PE	Kompania Rajonale e Ujit Hidrodrini (Pejë)
MIT	Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)
GJA	Kompania Rajonale e Ujit Gjakova (Gjakovë)
FE	Kompania Rajonale e Ujit Bifurkacioni (Ferizaj)
GJI	Kompania Rajonale e Ujit Hidromorava (Gjilan)
IL	NH Ibër Lepenci
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

1. HYRJE

Kemi kënaqësinë të paraqesim 'Raportin për performancën e kompanive të licensuara të furnizimit me ujë dhe furnizimit me shumicë të ujit për vitin 2025'.

Mandati i ARRU, si rregullator ekonomik, është të sigurojë që, konsumatorët të marrin shërbime cilësore dhe të besueshme, në përputhje me standardet e përcaktuara të shërbimit, me kosto sa më të ulët dhe të përballueshme për ta.

Si instrument rregullator për optimizimin e tregut, ARRU aplikon parimin e performancës krahasuese (benchmarking) të këtyre shërbimeve me qëllim të nxitjes së konkurrencës, motivimit për optimizimin e proceseve operacionale dhe komerciale në krahasim me praktikat më të mira në ofrimin e shërbimeve të ujit. Performanca e KRU matet dhe analizohet në mënyrë ndërlidhëse kundrejt objektivave tarifore dhe standardeve të përcaktuara të shërbimit.

Furnizimi me ujë të pijshëm si dhe shërbimi i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura janë ndër shtyllat kryesore për mirëqenien sociale dhe shëndetin publik. Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) kanë përgjegjësi të lartë jo vetëm për të siguruar furnizim të vazhdueshëm, të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë të ujit, por edhe për mbrojtjen e mjedisit.

Megjithëse nga viti në vit është evidentuar përmirësim i performancës së ofruesve të shërbimeve, në disa prej treguesve të rëndësishëm të performancës, si në nivel individual të ofruesve ashtu edhe në nivel të përgjithshëm të sektorit, edhe në 2025, kanë vazhduar disa përmirësime. Vazhdimësia e furnizimit me ujë të pijshëm në nivel sektori ka shënuar regres krahasuar me vitin paraprak. Cilësia Ujit të Pijshëm, mbetet në nivele të larta, ku 98.8% mostrave të analizuara janë në perputhje me standardet kombëtare, Shkalla e arkëtimit të të hyrave vazhdon të mbetet në nivel të mirë të performancës. Megjithatë, në dallim nga viti i kaluar, këtë vit është evidentuar një rënie prej 5% në efikasitetin e realizimit të investimeve kapitale nga të hyrat vetanake, me një normë realizimi prej rreth 51.4%.

Përkundër disa zhvillimeve pozitive në nivel të KRU si dhe sektori në përgjithësi, vazhdon të përballet me barriera serioze që rrezikojnë qëndrueshmërinë e progresit:

Ofruesit e shërbimeve shpenzojnë pjesën dërrmuese të të ardhurave për mbulimin e kostove fikse. Në këtë kuadër, kostot e personelit përbëjnë rreth 58% të shpenzimeve operative, ndërsa së bashku me shpenzimet e energjisë elektrike, këto kategori përbëjnë mbi 83% të totalit të shpenzimeve operative. Adresimi i kësaj sfide kërkon masa konkrete për rritjen e efikasitetit dhe kontrollin e kostove, duke u fokusuar në: racionalizimin e numrit të stafit dhe optimizimin e strukturës organizative; vendosjen e kontrolleve më të rrepta dhe forcimin e llogaridhënies në monitorimin e shpenzimeve operative; si dhe zbatimin e reformave menaxhuese dhe programeve të vazhdueshme të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Niveli i ulët i faturimit dhe humbjet e ujit po ashtu janë sfidë me vete. Uji i faturuar realisht arrin vetëm rreth 37% të totalit të ujit të prodhuar, ky deficit prej 63% (ujë i pafaturuar) vjen si pasojë e: humbjeve teknike (rrjedhjet / defektet në rrjetin shpërndarës) si dhe humbjeve komerciale (shfrytëzimi i pa-autorizuar i ujit, ujëmatësit e vjetëruar, gabimet në lexim dhe faturim). Kjo sfidë do të mund të menaxhohet duke realizuar investime kapitale në përputhje strikte me lartësinë dhe me dinamikat e miratuara nga ARRU, orientimin e investimeve në krijimin e Zonave të Matjes (DMA), instalimin e ujëmatësve dhe manometrave si dhe digjitalizimin e rrjetit përmes sistemeve të telemetrisë dhe mirëmbajtjes së rregullt të rrjetit shpërndarës.

Sfidat mjedisore dhe shëndetësore, që lidhen me tejkalimin e normave të lejuara të manganit në Liqenin e Badovcit dhe me mungesën e mbrojtjes adekuate të zonave përreth burimeve ujore, kërkojnë ndërmarrjen e masave konkrete.
Gjatë periudhës 2025 dhe 2026-2028, ARRU ka udhëhequr dy procese tarifore me ndikim strategjik në sektorin e shërbimeve të ujit në Kosovë. Po ashtu është realizuar ri-përtëritja e licencave të shërbimit për periudhën pesëvjeçare (2026–2031) për 7 KRU-të dhe Ndërmarrjen Hidro-Ekonomike. Kushtet e reja të licencës i kanë obliguar KRU që të adresojnë në mënyrë sistematike: qëndrueshmërinë operative dhe financiare, efikasitetin në menaxhimin e burimeve ujore si dhe sfidat e ngutshme mjedisore, me theks të veçantë trajtimin e ujërave të ndotura.

Këto nisma rregullatore do të shërbejnë si shtylla kryesore për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit, mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e përgjegjshmërisë së ofruesve të shërbimeve. Përcaktimit të tarifave për periudhën rregullatore 2026–2028 i parapriu një reformë e thellë strukturore tarifore, ky proces u diktua nga faktorë të jashtëm makroekonomikë, specifikisht nga presioni i inflacionit dhe rritja e vazhdueshme e kostove

operative, ku peshën kryesore e mban rritja e kostos së energjisë elektrike.

Për të siguruar qëndrueshmëri të ofruesve të shërbimit, ARRU miratoi një rritje të konsiderueshme të tarifave të shërbimeve të ujit. Ky vendim pati një ndikim të dyanshëm, në qëndrueshmëria e KRU, ku tarifat e reja rritën stabilitetin financiar të tyre, duke mundësuar mbulimin e kostove të shtuara të operimit, nga ana tjetër, ky ndryshim u reflektua me një rritje të menjëhershme të shpenzimeve mujore për konsumatoret shtepiak dhe ata komercialë-institucional.

Me qëllim që rritja tarifore dhe kriteret e rrepta të licencimit të përkthehen në vlerë të shtuar për publikun, ARRU është zotuar të rrisë presionin rregullator dhe monitorimin në dy drejtime kryesore: Ngritjen e efikasitetit komercial (përfshirë shkallën e arketimit dhe faturimit) si dhe zvogëlimin e ujit të pafaturuar, që mbetet një nga sfidat kryesore teknike të sektorit.

ARRU është i vendosur në arritje e objektivi final te këtyre zhvillimeve, e sidomos rritja e të hyrave të gjeneruara nga tarifat e reja të kthehet në një investim direkt për përmirësimin e dukshëm dhe të qëndrueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga KRU-të ndaj konsumatorëve.

Përmirësimi i shërbimeve të ujit është një proces i vazhdueshëm, i cili kërkon vizion afatgjatë, përgjegjësi institucionale dhe bashkëpunim të qëndrueshëm ndërmjet të gjithë akterëve. Autoriteti Rregullator do të vazhdojë të përmbushë rolin e tij në këtë proces, duke promovuar efikasitetin, qëndrueshmërinë financiare, transparencën dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Shpresojmë që informacionet, të dhënat dhe analizat e paraqitura në këtë Raport do tu shërbejnë të gjitha palëve të interesuara si bazë për planifikimin e mëtejshëm të investimeve, përcaktimin e prioriteteve dhe ndërmarrjen e masave konkrete në fushat ku janë evidentuar ngecje dhe nevojë për përmirësim.

ARRU shpreh mirënjohjen më të lartë për stafin e KRU-ve për bashkëpunimin e treguar dhe raportimin e rregullt të të dhënave, si dhe falënderon ekipin profesional të ARRU-së për përkushtimin e treguar në përgatitjen e këtij Raporti Kombëtar të Performancës për vitin 2025.

2. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ARRU ushtron funksionet e veta si autoritet rregullator për sektorin e ujit përmes këtyre autorizimeve dhe përgjegjësive kryesore:

- Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë
- Përcaktimin dhe miratimin e tarifave të shërbimeve, duke siguruar që ato të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve
- Vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga ofruesit e shërbimeve
- Monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve në raport me kushtet e licencës dhe objektivat e procesit tarifor
- Shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve në shkallën e dytë të procedurës administrative
- Hartimin dhe miratimin e rregulloreve, standardeve dhe vendimeve rregullatore në përputhje me ligjin
- Inspektimin e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit

Në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili emëron drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e ARRU-së. ARRU i paraqet komisionit parlamentar përkatës pranë Kuvendit raportin vjetor të punës për vitin paraprak, si dhe planin e punës me objektivat e performancës për periudhën pasuese. Gjithashtu, këto dokumente publikohen në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie ndaj publikut.

ARRU financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. ARRU realizon të hyra vetanake nga taksa vjetore e licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit, të cilat arketohen përmes llogarisë bankare të ARRU-së dhe, në përputhje me rregullat buxhetore në fuqi, transferohen në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, duke përbërë kontribut në financimin e përgjithshëm buxhetor.

3. PERFORMANCA E KOMPANIVE RAJONALE TË UJIT

Në këtë nën-kapitull është analizuar performanca e shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjlellësit (KRU) në lidhje me shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm për vitin 2025, është krahasuar performanca e vitit 2025 me atë të vitit 2024 dhe poashtu kundrejt caqeve / pritjeve që kanë qenë të përfshira në procesin tarifor 2025. Kjo pjesë e raportit është ndarë në nën-kapituj, performanca operative dhe performanca komerciale / financiare, veçmas për shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe për shërbimet e ujërave të ndotur.

3.1. Performanca operative - furnizimi me ujë

3.1.1. Cilësia e ujit

Furnizimi me ujë cilësor dhe i sigurt është përgjegjësi kryesore e ofruesve të shërbimeve të ujit, të cilët janë të obliguar të respektojnë standardet kombëtare të dhëna në Udhëzime Nr. 10/2021 "Për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsumim Njerëzor", si dhe standardet ndërkombëtare të OBSH-së dhe Direktivës së BE-së për ujë të pijshëm.

Në këtë raport, analiza dhe vlerësimi i cilësisë së ujit kundrejt standardeve në fuqi janë bazuar edhe këtë vite në të dhënat zyrtare të raportuara nga IKSHPK.

Niveli i përputhshmërisë së kualitetit të ujit, i prezantuar në figurat 1 dhe 2, tregon përqindjen e testeve, bakteriologjike dhe fiziko-kimike, të cilat përmbushin vlerat referente vendore të cilesis së ujit.




Figura 1. Përputhshmëria e testeve bakteriologjike

Në aspektin bakteriologjik, gjatë vitit 2025 janë testuar gjithsej 9,399 mostra uji, prej të cilave 99.5% kanë qenë në përputhje me standardet, ndërsa 0.5% mostra nuk kanë qenë në përputhje me standardet. Krahasuar me vitin 2024, kur përputhshmëria ishte 98.9%, vërehet një përmirësim prej 0.6 pikë përqindjeje në nivel sektori.

Në shumicën e KRU-ve është ruajtur ose përmirësuar niveli i përputhshmërisë. KRU Prishtina ka shënuar përputhshmëri 100% në vitin 2025, krahasuar me 98.9% në vitin 2024, ndërsa KRU Gjakova ka ruajtur nivelin maksimal prej 100%. Përmirësim të dukshëm ka shënuar edhe KRU Hidroregjioni Jugor, nga 97.3% në 2024 në 99.9% në 2025. KRU Hidromorava ka shënuar përmirësim të përputhshmërisë bakteriologjike, nga 99.7% në vitin 2024 në 100% në vitin 2025.

Nga ana tjetër, KRU Bifurkacioni ka shënuar rënie të lehtë të përputhshmërisë, nga 95.8% në vitin 2024 në 94.3% në vitin 2025, duke mbetur kompania me përputhshmërinë më të ulët bakteriologjike në vitin 2025. KRU Mitrovica ka mbetur ne pozitë e njëjtë me 99.5%, ndërsa KRU Hidrodrini ka shënuar përmirësim nga 97.3% në 99.9%.




Figura 2. Përputhshmëria e testeve fiziko-kimike

Në aspektin fiziko-kimik, gjatë vitit 2025 janë testuar gjithsej 8,051 mostra, prej të cilave 98.0% kanë qenë në përputhje me standardet, ndërsa 2.0% kanë rezultuar të jenë jashtë standardeve të përputhshmërisë. Krahasuar me vitin 2024, kur përputhshmëria ishte 98.8%, në vitin 2025 është evidentuar një rënie prej 0.8 pikë përqindjeje në nivel sektori.

Në aspektin e përputhshmërisë fiziko-kimike, KRU Gjakova dhe KRU Hidromorava kanë shënuar performancë të plotë, me 100% përputhshmëri në vitin 2025. Ndërkohë, KRU Prishtina ka shënuar regres krahasuar me vitin paraprak, duke kaluar nga 99.5% në vitin 2024 në 96.9% në vitin 2025. Regres është evidentuar edhe te KRU Hidroregjioni Jugor, nga 100% në vitin 2024 në 99.3% në vitin 2025, si dhe te KRU Mitrovica, nga 99.8% në 2024 në 95.9% në 2025.

KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidrodrini kanë shënuar përputhshmëri prej 97.2% në vitin 2025. Në nivel sektori, përputhshmëria fiziko-kimike ka shënuar rënie nga 98.8% në vitin 2024 në 98.0% në vitin 2025, çka tregon nevojën për vëmendje të mëtejshme në monitorimin dhe trajtimin e parametrave fiziko-kimikë.

Numri më i lartë i mostrave që nuk kanë qenë në përputhje me standardet është evidentuar te KRU Hidrodrini, me 61 mostra, pasuar nga KRU Mitrovica me 53 dhe KRU Prishtina me 29 mostra.

Edhe gjatë vitit 2025 sikurse edhe tri vitet paraprake, KRU Prishtina është përballur me vështirësi në aspektin e cilësisë fiziko-kimike të ujit të prodhuar dhe shpërndarë, kryesisht si pasojë e pranisë së manganit në Liqenin e Badovcit.

Për këtë arsye, ARRU ka kërkuar që problematika të adresohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore, në bashkëpunim të ngushtë me IKSHPK, si institucioni përgjegjës për garantimin e cilësisë së ujit të ofruar nga KRU-të.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) dhe Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) kanë kërkuar nga KRU Prishtina të ndërmarrë masa të shtuara për monitorimin e cilësisë së ujit për zonën e shërbimit që është furnizuar nga Ipmianti i Përpunimit të Ujit në Badovc dhe korrigjimin e procesit të përpunimit të ujit në ITU Badovc. KRU Prishtina ka zbatuar disa masa emergjente pas së cilave situata me përqendrimin e lartë të manganit është tejkaluar.

3.1.2. Shtypja

KRU-të janë të obliguara të furnizojnë në vazhdimësi konsumatorët e tyre me ujë me presion të mjaftueshëm[1] në rrjetin e ujësjellësit. Ky tregues definon numrin e pronave që ndikohen rregullisht nga presioni i ulët, duke përjashtuar rastet aksidentale të herë pas hershme të rënies së presionit.

[1] Referenca Ligjore 'RREGULLORE NR.10/2019 PËR STANDARDET MINIMALE TË SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË', thekson se: Në kushtet e zakonshme të përdorimit të ujit, presioni hidraulik në gypin e lidhjes së konsumatorit duhet të jetë jo më pak se një e gjysëm (1.5) bar dhe jo më shumë se shtatë (7) bar.

Është evidente se menaxhimi i presionit në rrjetin shpërndarës, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë që ka në kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara të ujit, është metodë e rendësishme për menaxhimin e humbjeve të ujit si dhe ruajtjen e jetëgjatësisë së rrjetit të ujësjellësit.




Figura 3. Pronat e ndikuara nga presioni ulët

Të dhënat tregojnë se ekziston një problem i pranishëm me presionin minimal të ujit për disa KRU, megjithatë besueshmëria e këtyre të dhënave është e kufizuar për shkak të mungesës së pajisjeve të matjes dhe monitorimit. Për të rritur cilësinë e shërbimit dhe për të menaxhuar më mirë humbjet e ujit, KRU-të duhet të përmirësojnë sistemet e tyre të monitorimit të presionit, duke ndarë rrjetin në zona presioni dhe duke instaluar manometra në pika kyçe të rrjetit.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën 3, disa KRU kanë raportuar përqindje të konsumatorëve nën presionin minimal.

Në vitin 2025, vërehet një rritje e këtij treguesi në disa KRU. KRU Bifurkacioni ka shënuar nivelin më të lartë te konsumatorëve me mungesë të presionit me 2.56%, pasuar nga KRU Prishtina me 1.95%, KRU Hidroregjioni Jugor me 1.90% dhe KRU Hidromorava me 0.92%, ndërsa te KRU Mitrovica treguesi ka mbetur në nivelin 0.03%. KRU Gjakova dhe KRU Hidrodrini kanë raportuar 0.00% edhe në vitin 2025.

Dallimet në vlerat e raportuara ndërmjet KRU-ve dhe ndryshimet nga njëri vit në tjetrin kërkojnë monitorim të vazhdueshëm të presionit në rrjet për të siguruar besueshmërinë e të dhënave. Mungesa e manometrave në pikat kyçe të rrjetit dhe mosndarja e rrjetit në zona presioni mund të ndikojnë në identifikimin dhe evidentimin e saktë të konsumatorëve me presion të pamjaftueshëm. Për këtë arsye, rekomandohet që KRU-të të përmirësojnë monitorimin e presionit përmes instalimit të manometrave në pika strategjike dhe ndarjes së rrjetit në zona presioni, duke mundësuar menaxhim më efektiv dhe raportim më të besueshëm të këtij treguesi.

3.1.3. Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Monitorimi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë pasqyron treguesin e performancës i cili merr për bazë numrin e pronave të prekura / ndikuara nga disponueshmëria me shërbim të furnizimit me ujë dhe është ndarë në tre kategori: prona që kanë furnizim 24 orë në ditë, prona që kanë furnizim midis 18-23 orë në ditë dhe ato me më pak se 18 orë furnizim në ditë.

Në përgjithësi, furnizimi me ujë në Kosovë është përmirësuar në vazhdimësi si rezultat i investimeve në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në të gjitha KRU-të, megjithatë furnizimi i vazhdueshëm për 24 orë në ditë në disa KRU ende nuk mund te sigurohet, ndërsa të dhënat e raportuara për vazhdimësinë e furnizimit me ujë, ARRU i vlerëson të jenë me besueshmëri të ulët, pasi zonat e shërbimit ende nuk janë të ndara në zona të matura të ujit (DMA – District Metered Area) përmes të cilave do të monitorohej furnizimi i rregullt me ujë i konsumatorëve.

Tabela 1. Vazhdimësia e furnizimit me ujë e konsumatorëve

	<18 h furnizim %		18-23 h furnizim %		24 h furnizim %	
KRU	**2024**	**2025**	**2024**	**2025**	**2024**	**2025**
PR	5.23%	3.26%	1.59%	2.92%	93.18%	93.82%
PZ	0.00%	7.39%	0.00%	1.93%	100.00%	90.68%
PE	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
MIT	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
GJA	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
FE	0.00%	0.00%	0.98%	37.99%	99.02%	62.01%
GJI	0.17%	0.16%	0.81%	0.76%	99.02%	99.08%

Tabela 1 paraqet të dhënat e raportuara për vazhdimësinë e furnizimit me ujë për vitet 2024 dhe 2025. Në vitin 2025, shumica e KRU-ve kanë raportuar nivel të lartë të furnizimit 24 orë në ditë, megjithatë në disa raste vërehen ndryshime të theksuara krahasuar me vitin 2024.

KRU Prishtina në vitin 2025 ka raportuar 93.82% të konsumatorëve me furnizim 24 orë në ditë, krahasuar me 93.18% në vitin 2024, duke shënuar një përmirësim të lehtë. Për konsumatorët me furnizim më pak se 18 orë, në vitin 2025 është raportuar 3.26%, nga 5.23% në vitin 2024, ndërsa për kategorinë 18–23 orë furnizim është raportuar 2.92%, krahasuar me 1.59% në vitin 2024.

KRU Hidroregjioni Jugor në vitin 2025 ka raportuar 90.68% të konsumatorëve me furnizim 24 orë në ditë, nga 100% sa ishte në vitin 2024. Në të njëjtën kohë, 7.39% e konsumatorëve kanë pasur furnizim më pak se 18 orë dhe 1.93% furnizim 18–23 orë, ndërsa në vitin 2024 nuk ishin raportuar konsumatorë në këto dy kategori. Kjo paraqet një përkeqësim të dukshëm të vazhdimësisë së furnizimit në vitin 2025.

KRU Bifurkacioni ka raportuar në vitin 2025 vetëm 62.01% të konsumatorëve me furnizim 24 orë në ditë, krahasuar me 99.02% në vitin 2024. Ndërkohë, 37.99% e konsumatorëve kanë pasur furnizim 18–23 orë, nga vetëm 0.98% sa ishte në vitin 2024. Ky është ndryshimi më i theksuar negativ ndërmjet dy viteve dhe tregon një përkeqësim të konsiderueshëm të vazhdimësisë së furnizimit në KRU Ferizaj. Megjithatë, vlen të theksohet se KRU Bifurkacioni ka mbajtur dhe raportuar të dhënat për vazhdimësinë e furnizimit në mënyrë më të detajuar dhe më të konsoliduar se KRU-të e tjera, duke mundësuar një pasqyrë më të qartë të shpërndarjes së konsumatorëve sipas orëve të furnizimit. Për këtë arsye, ndryshimi i evidentuar në vitin 2025 duhet të konsiderohet edhe në kontekstin e cilësisë dhe detajimit të raportimit të të dhënave nga kjo kompani.

KRU Hidromorava në vitin 2025 ka raportuar 99.08% të konsumatorëve me furnizim 24 orë në ditë, krahasuar me 99.02% në vitin 2024, duke shënuar një përmirësim të lehtë. Për kategorinë e furnizimit 18–23 orë, në vitin 2025 janë raportuar 0.76%, nga 0.81% në vitin 2024, ndërsa furnizimi më pak se 18 orë ka rënë nga 0.17% në 0.16%.

KRU Hidrodrini, KRU Mitrovica dhe KRU Gjakova kanë ruajtur në vitin 2025 nivelin prej 100% të konsumatorëve me furnizim 24 orë, njësoj sikurse në vitin 2024. Për këto tri KRU nuk janë raportuar konsumatorë me furnizim më pak se 24 orë në asnjërin prej dy viteve.




Figura 4. Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Dallimet e konsiderueshme ndërmjet KRU-ve dhe ndryshimet nga njëri vit në tjetrin e bëjnë të domosdoshëm monitorimin dhe evidentimin e saktë të ndërprerjeve dhe reduktimeve të furnizimit. Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara janë të rëndësishme për vlerësimin real të vazhdimësisë së shërbimit dhe për identifikimin e zonave ku nevojiten masa për përmirësimin e furnizimit me ujë.

Situata në terren mund të jetë edhe më e pafavorshme, për shkak të mungesës së monitorimit efektiv të shtypjeve në kohë reale në zonën e shërbimit.

3.1.4. Defektet në rrjetin e ujësjellësit

Shërbyeshmëria infrastrukturore është aftësia e aseteve për të ofruar nivelet e kërkuara të shërbimit, dështimet e të cilave i atribuohen plasaritjes (dëmtimit) së gypave.

Plasaritjet e gypave për 100 km rrjet në vit, kanë shfaqur luhatje të konsiderueshme gjatë periudhës 2015–2025. Treguesi u rrit nga 196 plasaritje në vitin 2015 në nivelin më të lartë prej 233 në vitin 2017, ndërsa më pas shënoi një tendencë përgjithësisht rënëse, me nivelin më të ulët prej 169 në vitin 2022. Pas një rritjeje në 193 plasaritje në vitin 2023, treguesi ka vijuar të ulet, duke arritur në 178 në vitin 2024 dhe 176 në vitin 2025. Pavarësisht kësaj rënieje në vitet e fundit, niveli i plasaritjeve mbetet relativisht i lartë dhe mund të lidhet me gjendjen e infrastrukturës, mirëmbajtjen dhe investimet në rehabilitimin e rrjetit. Variacionet ndër vite duhet të interpretohen me kujdes, duke marrë parasysh edhe ndryshimet në mënyrën e evidentimit dhe raportimit të plasaritjeve nga KRU-të.




Figura 5. Defektet e gypave në rrjetin e ujësjellësit, 2024–2025




Figura 6. Defektet e raportuara në rrjetin e ujësjellësit

Në vitin 2025, performanca e KRU-ve lidhur me numrin e defekteve për 100 km të rrjetit paraqet një situatë të përzier krahasuar me vitin 2024. Në përgjithësi, pesë nga tetë KRU kanë shënuar përmirësim, ndërsa tri KRU kanë pasur rritje të numrit të defekteve.

KRU Hidroregjioni Jugor ka shënuar përmirësimin më të madh, me ulje të defekteve nga 336 në 210 për 100 km, ose rreth 37.5%. Përmirësim të dukshëm ka shënuar edhe KRU Bifurkacioni, ku defektet kanë rënë nga 130 në 98 për 100 km. KRU Gjakova dhe KRU Prishtina kanë shënuar përmirësime më të moderuara, ndërsa mesatarja e sektorit ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraprak.

Në anën tjetër, KRU Mitrovica ka shënuar përkeqësimin më të madh, me rritje të defekteve nga 48 në 123 për 100 km, ndërsa KRU Hidromorava ka kaluar nga 88 në 134 defekte për 100 km. KRU Hidrodrini gjithashtu ka shënuar një rritje të lehtë, nga 260 në 272 defekte për 100 km, duke mbetur KRU-ja me nivelin më të lartë të defekteve në vitin 2025.

Në tërësi, rezultatet tregojnë se, megjithëse shumica e KRU-ve kanë përmirësuar këtë tregues në vitin 2025, niveli i defekteve mbetet relativisht i lartë në disa kompani, çka tregon nevojën për investime të vazhdueshme në rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit, si dhe përmirësimin e menaxhimit të aseteve.

3.1.5. Uji i pa-faturuar

Uji i pa-faturuar përfaqëson pjesën e ujit të trajtuar dhe të futur në rrjetin shpërndarës e që nuk arrin të faturohet, pra humbjet e ujit që ndodhin përpara se uji të arrijë tek konsumatori dhe që nuk sjellin të ardhura për kompanitë.

Në vitin 2025, UPF në nivel sektori është në nivel shumë të lartë, prej 63%, që do të thotë se më shumë se gjysma e ujit të prodhuar nuk faturohet dhe nuk gjeneron të ardhura. Ky tregues megjithëse shprehet në përqindje dhe ka kufizimet e tij ofron një pasqyrë të menjëhershme të gjendjes së infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit, që është në gjendje të rëndë dhe me humbje të mëdha të ujit.




Figura 7. Performanca krahasuese për UPF, paraqitur si litra për konsumator për ditë dhe si % e prodhimit[2]

Nuk është reale të pritet që KRU-të, brenda një periudhe të shkurtër kohore, të arrijnë reduktime drastike të nivelit të Ujit të Pafaturuar. Reduktimet e konsiderueshme të UPF-së kërkojnë një qasje të integruar e cila kombinon investimet kapitale në ripërtëritjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit me përmirësime të qëndrueshme në menaxhimin mirëmbajtjen dhe monitorimin e rrjetit.

Megjithatë, analiza e të dhënave për vitet 2024 dhe 2025 tregon se niveli i UPF-së mbetet i lartë, çka dëshmon se masat e ndërmarra deri më tani nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një trend të qëndrueshëm të reduktimit. Përmirësimi i situatës kërkon që KRU-të të përmbushin në mënyrë të qëndrueshme planet e investimeve të parapara në planet e tyre të biznesit, duke i orientuar ato në mënyrë strategjike drejt rehabilitimit të rrjetit menaxhimit të presionit,kontrollit të humbjeve fizike si dhe përmirësimit të matjes dhe faturimit.

Nëse investimet e planifikuara nuk realizohen në nivelin dhe afatet e parapara, dhe nëse nuk ndërmerren masa të strukturuara për menaxhimin e humbjeve, ekziston rreziku që niveli i UPF-së të mbetet i lartë ose të përkeqësohet më tej. Për këtë arsye, reduktimi i UPF-së duhet të trajtohet si një objektiv afatmesëm dhe afatgjatë i mbështetur në investime të mjaftueshme planifikim strategjik dhe monitorim të vazhdueshëm të rezultateve.

Krahasimet e nivelit të UPF-së duhet të trajtohen me kujdes, pasi paraqitja vetëm si përqindje e prodhimit mund të çojë në keqinterpretim. Për të mundësuar krahasimin e performancës së KRU-ve me madhësi të ndryshme përdoret treguesi litër për kyçje në ditë (l/kyçje/ditë). Në vitin 2025 vlerat e UPF-së variojnë nga 255 l/kyçje/ditë në KRU Bifurkacioni deri në 1,636 l/kyçje/ditë në KRU Hidrodrini.

Sipas praktikave ndërkombëtare (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit - IWA), humbjet mbi 600 l/kyçje/ditë, në një presion mesatar prej rreth 30 m konsiderohen si përdorim jashtëzakonisht joefikas i burimeve dhe kërkojnë programe prioritare për reduktimin e humbjeve. Në vitin 2025, katër KRU (Hidrodini, Hidroregjioni Jugor dhe Mitrovica) tejkalojnë këtë prag, poashtu edhe në vitin 2024 mbi këtë pragë ishin po këto katër KRU. Megjithatë, trend i përmirësimit vërehet tek: KRU Bifurkacioni, Hidrodrini, Mitrovica dhe Prishtina, ndërsa KRU Hidroregjioni Jugor, Gjakova dhe KRU Hidromorava kanë shënuar rritje të UPF-së. Këto rezultate tregojnë se, pavarësisht përmirësimeve të evidentuara në disa KRU, niveli i UPF-së mbetet i lartë dhe kërkon masa të qëndrueshme për reduktimin e humbjeve, veçanërisht në KRU-të me vlera mbi pragun ndërkombëtar prej 600 l/kyçje/ditë.

Ky nën-sesion fokusohet mbi aspektet komerciale të furnizimit me ujë të tilla si mbuleshmëria me shërbime, matja dhe ankesat me fokusim në ato aspekte që kanë ndikim në konsumatorë.

3.1.6. Mbulueshmëria me shërbime

Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohen nga sistemet e menaxhuara nga KRU në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit.

[2] Vlera e UPF për kyçje në ditë është përshtatur/rregulluar që të kompensojë orët e shërbimit në ditë.




Figura 8. Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë

Sipas të dhënave të paraqitura, mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit në vitin 2025 ka mbetur e pandryshuar në nivel sektori, në 83%, krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, në nivel të KRU-ve janë evidentuar ndryshime.

KRU Prishtina ka ruajtur nivelin e mbulueshmërisë prej 88%, duke treguar qëndrueshmëri në ofrimin ndaj shërbimeve të ujësjellësit. KRU Mitrovica ka shënuar një rritje të lehtë, përkatësisht nga 84% në 85%.

Rritje më e theksuar është evidentuar te KRU Hidromorava, ku mbulueshmëria është rritur nga 66% në 69%, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm të aksesit të popullsisë në shërbimet e ujësjellësit. Ndërkohë, KRU Hidroregjioni Jugor ka shënuar një rënie të lehtë, nga 72% në 70%.

KRU Gjakova vazhdon të ketë mbulueshmërinë më të lartë në sektor, duke ruajtur nivelin prej 99% edhe gjatë vitit 2025. Në anën tjetër, KRU Bifurkacioni ka regjistruar rënien më të theksuar të këtij treguesi, nga 80% në 75%, duke paraqitur një ulje prej 5 pikë përqindjeje.

Në përgjithësi, mbulueshmëria në nivel sektori prej 83% në vitin 2025 tregon se, pavarësisht ndryshimeve ndërmjet KRU-ve, niveli i përgjithshëm i aksesit në shërbimet e ujësjellësit ka mbetur i pandryshuar krahasuar me vitin 2024.

3.2. Performanca komerciale dhe financiare - furnizimi me ujë

3.2.1. Matja e ujit

Matja e ujit, përveç përmbushjes së obligimit ligjor të KRU-ve për faturim të saktë dhe të drejtë bazuar në konsumin e matur, është një mekanizëm i rëndësishëm për menaxhimin e humbjeve të ujit dhe nxitjen e konsumatorëve për përdorim racional të ujit. Pajisja e konsumatorëve me ujëmatës mundëson matjen e saktë të konsumit dhe krijon bazë më të mirë për identifikimin dhe menaxhimin e humbjeve.




Figura 9. Përqindja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Në vitin 2025, mbulimi i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës në nivel sektori ka arritur në 99.6%, duke shënuar një përmirësim prej 0.2 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2024, kur mbulimi ishte 99.4%. Të dhënat tregojnë se shumica e KRU-ve kanë arritur nivele shumë të larta të pajisjes me ujëmatës, mbi 99%.

KRU Bifurkacioni vazhdon të ruajë mbulimin maksimal prej 100% edhe në vitin 2025, duke mos shënuar ndryshim krahasuar me vitin paraprak. KRU Gjakova, Prishtina dhe KRU Hidrodrini kanë shënuar përmirësim të lehtë, duke kaluar nga 99.8% në 99.9%. Po ashtu, KRU Hidromorava ka shënuar rritje nga 99.6% në 99.7%.

Përmirësimi më i theksuar është evidentuar te KRU Mitrovica, ku mbulimi me ujëmatës është rritur nga 96.2% në 97.9%, duke shënuar një rritje prej 1.7%. Megjithatë kjo KRU vazhdon të ketë nivelin më të ulët të mbulimit me ujëmatës në sektor, duke treguar se ende ekziston hapësirë për përmirësim. Në anën tjetër, KRU Hidroregjioni Jugor ka shënuar një rënie të lehtë, nga 99.7% në 99.5

Rritja e mbulimit me ujëmatës në nivel sektori nga 99.4% në 99.6% paraqet një përmirësim pozitiv, ndërsa fokusi i mëtejshëm duhet të jetë në pajisjen e konsumatorëve që ende nuk kanë ujëmatës, veçanërisht në KRU Mitrovica si dhe në zëvendësimin e ujëmatësve të vjetër me ujëmatës të rinj me qëllim sigurimin e saktësisë së matjes faturimit dhe menaxhimit më efikas të humbjeve të ujit.

3.2.2. Ankesat

Ky tregues paraqet numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuara nga KRU-të nga konsumatorët lidhur me shërbimet e ujësjellësit. Ankesat mund të parashtrohen me shkrim, përmes telefonit ose drejtpërdrejt tek KRU-të. Evidentimi dhe analiza e tyre janë të rëndësishme për monitorimin e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Tabela 2. Ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujit

	Ankesat teknike			Ankesat komerciale		
KRU	**2024**	**2025**	**Raporti krahasues: 2025/2024**	**2024**	**2025**	**Raporti krahasues: 2025/2024**
PR	2,676	3,632	36%	1211	777	-36%
PZ	3,474	2,745	-21%	895	814	-9%
PE	3,335	3,516	5%	132	73	-45%
MIT	1,751	513	-71%	174	226	30%
GJA	1064	1487	40%	1185	537	-55%
FE	361	284	-21%	286	275	-4%
GJI	94	207	120%	190	265	39%
Totali	**12,755**	**12,384**	**-3%**	**4,073**	**2,967**	**-27%**

Në vitin 2025, numri i ankesave teknike në nivel sektori ka shënuar rënie prej 3%, nga 12,755 në 12,384 ankesa. Rritje të ankesave teknike kanë shënuar KRU Prishtina prej 36%, Gjakova 40% dhe KRU Hidromorava 120%, ndërsa rënia më e theksuar është evidentuar në KRU Mitrovica me 71%.

Ankesat komerciale kanë shënuar një rënie prej 27%, nga 4,073 në 2,967 ankesa. Rënie të theksuar kanë Hidrodrini, KRU Prishtina dhe KRU Gjakova 55%, ndërsa rritje janë evidentuar në KRU Mitrovica 30% dhe KRU Hidromorava 39%.

Ndryshimet e konsiderueshme ndërmjet KRU-ve tregojnë nevojën për evidentim, klasifikim dhe raportim më të standardizuar të ankesave, në mënyrë që të dhënat të jenë më të krahasueshme dhe të përdoren në mënyrë efektive për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

3.2.3. Shitjet volumetrike

Vëllimi i ujit të shitur ndikon drejtpërdrejt në efiçencën financiare të kompanive, pasi që sa më i lartë të jetë faturimi në raport me prodhimin, aq më të qëndrueshme janë financiarisht kompanitë. Shitjet volumetrike ndikojnë kryesisht në ngarkesën tarifore. Figura 10 tregon performancën e shitjeve të ujit krahasuar me planifikimet përmes procesit tarifor 2025.




Figura 10. Shitjet e ujit në raport me shitjet e planifikuara gjatë rishikimit tarifor 2025

Sipas të dhënave të figurës 10, në vitin 2025 KRU Mitrovica ka tejkaluar planifikimin për shitjen e ujit, duke realizuar 110% të planit, ndërsa KRU Bifurkacioni ka realizuar 98%, duke qenë pranë planifikimit. KRU Hidrodrini dhe KRU Gjakova kanë realizuar nga 95% të shitjeve ne raport me planin ndërsa KRU Prishtina 94%.

Në nivel sektori, realizimi mesatar i shitjeve volumetrike është rritur nga 90% në vitin 2024 në 94% në vitin 2025, duke treguar përmirësim në realizimin e planifikimeve. Megjithatë, disa KRU vazhdojnë të jenë nën nivelin e planifikuar, veçanërisht KRU Hidromorava me 82% dhe KRU Hidroregjioni Jugor me 86%.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë përmirësim të realizimit të shitjeve volumetrike në vitin 2025, megjithëse dallimet ndërmjet KRU-ve mbeten të dukshme dhe kërkojnë vëmendje në planifikimin dhe realizimin e vëllimeve të shitjes së ujit.

3.2.4. Shitjet në vlerë monetare

Edhe gjatë këtij viti, vlera e realizuar e shitjeve për çdo KRU rezultoi më e ulët krahasuar me vlerën e planifikuar (shih Figurën 11). Ky rezultat lidhet kryesisht me pasaktësinë e parashikimeve të vëllimit të shitjeve, siç është shpjeguar në treguesin e paraqitur më sipër.




Figura 11. Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara të përcaktuara në rishikimin tarifor 2022-2025

Mesatarja e shitjeve në vlerë monetare në nivel sektori e realizuar për vitin 2025 ishte 94% në raport me planifikimin, duke rezultuar 6% më e ulët se objektivi i përcaktuar në BPRR për vitin 2025. Megjithatë, krahasuar me vitin 2024, është shënuar një përmirësim i lehtë në realizimin e shitjeve.

Në nivel të kompanive, me përjashtim të KRU "Mitrovica", kompanitë e tjera nuk kanë arritur të përmbushin objektivat e shitjeve të planifikuara sipas BPRR per vitin 2025 dhe të aprovuara nga Rregullatori. Performanca më e mirë është shënuar nga KRU "Mitrovica", e cila realizoi 110% të objektivit të planifikuar, duke tejkaluar planifikimin për 10%. Në anën tjetër, KRU "Hidromorava" paraqitet me performancën më të ulët, me realizim prej vetëm 84% të objektivit, duke shënuar gjithashtu përkeqësim krahasuar me vitin paraprak.

Mosrealizimi i vlerës së planifikuar të shitjeve ka ndikim të drejtpërdrejtë në kapacitetin financiar të KRU-ve, duke kufizuar burimet e disponueshme për financimin e shpenzimeve dhe realizimin e planeve të investimeve. Megjithatë, pavarësisht mosarritjes së objektivave të planifikuara, vlera absolute e shitjeve ka shenuar trend pozitiv në raport me vitin paraprak, me një rrijte për 4%.

Tabela 3 paraqet të dhënat statistikore mbi realizimin e shitjeve të ujit në vlerë monetare, në raport me vlerat e planifikuara në aplikacionet tarifore të KRU-ve gjatë proceseve tarifore për vitet 2024 dhe 2025.

Tabela 3. Shitjet e realizuara dhe të planifikuara për vitet 2024-2025

KRU	Vlera e shitjeve (Euro)						Raporti: realizimi 2025/realizimi 2024
	2024			2025			
	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	
PR	15,214,523	14,693,787	97%	15,770,601	14,670,864	93.0%	-0.16%
PZ	4,868,749	4,261,696	88%	4,946,613	4,446,204	90%	4.33%
PE	3,834,861	3,457,514	90%	4,129,907	3,818,456	92%	10.44%
MIT	3,853,362	3,694,393	96%	3,901,966	4,277,771	110%	15.79%
GJA	4,957,019	3,925,127	79%	4,288,057	4,031,554	94%	2.71%
FE	2,291,137	2,368,741	103%	2,513,993	2,500,491	99%	5.56%
GJI	2,356,907	2,134,552	91%	2,660,925	2,224,354	84%	4.21%
Sektori	**37,376,559**	**34,535,811**	**92%**	**38,212,061**	**35,969,694**	**94%**	**4.15%**

Vlera e shitjeve monetare të realizuara për furnizim me ujë në nivel të sektorit gjatë vitit 2025 ishte rreth 36 milionë €, kundrejt rreth 38 milionë € të planifikuara, duke rezultuar me një diferencë prej rreth 2.2 milionë €, ose rreth 5.9% nën nivelin e planifikuar. Kjo tregon se, pavarësisht rritjes së vlerës absolute të shitjeve krahasuar me vitin 2024, performanca e sektorit në raport me objektivat e planifikuara vazhdon të mbetet nën nivelin e pritshëm.

Rritja e vlerës absolute të shitjeve lidhet kryesisht me zgjerimin e bazës së konsumatorëve dhe rritjen e shitjeve volumetrike. Megjithatë, kjo rritje nuk ka qenë e mjaftueshme për të arritur nivelin e parashikuar në procesin tarifor. Diferenca ndërmjet realizimit dhe planifikimit nënkupton më pak të ardhura të gjeneruara nga aktiviteti bazë i KRU-ve, duke ndikuar në kapacitetin e tyre për mbulimin e kostove operative, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe sigurimin e burimeve për realizimin e investimeve kapitale.

Në këtë kuadër, mosrealizimi i përsëritur i objektivave të shitjeve, si në aspektin volumetrik ashtu edhe në atë monetar, paraqet një sfidë për planifikimin financiar të KRU-ve. Diferencat ndërmjet vlerave të planifikuara dhe atyre të realizuara kërkojnë vëmendje më të madhe në procesin e planifikimit dhe në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në realizimin e shitjeve, me qëllim që objektivat e ardhshme të jenë më të arritshme dhe në përputhje me performancën reale të sektorit.




Figura 12. Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2025 në raport me vitin 2024

Nga Figura 12 shihet se gjatë vitit 2025, gjashtë nga shtatë KRU-të kanë shënuar rritje në vlerën e shitjeve të realizuara krahasuar me vitin 2024. Rritja më e lartë është evidentuar te KRU "Mitrovica", me 15.8%, e cila

lidhet kryesisht me zgjerimin e bazës së konsumatorëve të shërbimit të furnizimit me ujë. Zgjerimi i numrit të konsumatorëve ka ndikuar në rritjen e shitjeve volumetrike, të cilat në këtë kompani janë rritur për 11% krahasuar me vitin paraprak.

Në anën tjetër, KRU "Prishtina" mbetet e vetmja kompani që ka shënuar rënie të vlerës së shitjeve krahasuar me vitin 2024, me një ulje prej 0.2%. Megjithëse kjo rënie është relativisht e vogël, performanca e saj mbetet më e dobët krahasuar me atë të kompanive të tjera të sektorit dhe kërkon vëmendje në raport me trendet e shitjeve dhe faktorët që kanë ndikuar në këtë rezultat.

Në nivel sektori, vlera e shitjeve të realizuara në vitin 2025 është rritur për 4.15% krahasuar me vitin 2024, rezultat i rritjes së shitjeve volumetrike me 2%. Rritja më e lartë e vlerës monetare në raport me rritjen e volumit të shitjeve tregon se përmirësimi i të ardhurave nga shitjet nuk është mbështetur vetëm në rritjen e sasisë së ujit të shitur, por edhe në faktorë të tjerë që ndikojnë në vlerën e faturuar.

Megjithatë, pavarësisht këtij përmirësimi krahasuar me vitin paraprak, realizimi i shitjeve në nivel sektori ende mbetet nën objektivat e planifikuara.

3.2.5. Kostot

Kostot për njësi janë analizuar përmes tre treguesve kryesorë:

- Kostot operative dhe mirëmbajtja kapitale në raport me planifikimet,
- Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar, dhe
- Kostoja totale për njësi të ujit të shitur.

Të dhënat statistikore për secilin nga këta tregues paraqiten në figurat në vijim.

Kostot operative dhe mirëmbajtja kapitale në raport me planifikimet

Kostot operative, perfshirë mirëmbajtjen kapitale (përtëritjen e infrastrukturës dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale) për ujësjellës në raport me planifikimet paraqesin një nga treguesit financiarë që bëjnë pjesë në grupin e treguesve kyç të performancës, përmes të cilëve vlerësohet niveli i performancës së shërbimeve të ujësjellësit. Ky tregues paraqet raportin ndërmjet kostove të realizuara, përkatësisht shpenzimeve operative të realizuara, përfshirë mirëmbajtjen kapitale, dhe kostove të planifikuara. Përmes këtij treguesi vlerësohet shkalla e realizimit të kostove në raport me planifikimet përkatëse.




Figura 13. Shpenzimet operative dhe mirembajtja kapitale në raport me planin

Nga Figura 13, sa i perket shpenzimeve operative ne raport me planin shihet se gjatë vitit 2025, shumica e KRU-ve kanë realizuar shpenzime operative mbi nivelin e planifikuar, duke treguar tejkalim të planit buxhetor.

Rritja më e theksuar e realizimit të shpenzimeve operative ndaj planit është evidentuar te KRU "Hidroregjioni Jugor" me 142%, pasuar nga KRU "Mitrovica" me 125%. Ndërkohë, KRU "Hidromorava" ka realizuar 112% të shpenzimeve operative të planifikuara. Edhe pse ky nivel është më i ulët në krahasim me KRU-të e tjera, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht performancë më të mirë në menaxhimin e shpenzimeve, pasi edhe në këtë rast shpenzimet faktike kanë tejkaluar nivelin e planifikuar.

Në krahasim me vitin 2024, vërehet rritje e këtij raporti të shumica e kompanive, ndërsa te KRU "Hidrodrini" realizimi i shpenzimeve operative ndaj planit ka shënuar rënie.

Në përgjithësi, realizimi mbi 100% i shpenzimeve operative te të gjitha KRU-të tregon se shpenzimet faktike kanë tejkaluar planifikimet e përcaktuara për vitin 2025. Ky tejkalim paraqet nevojë për vëmendje të veçantë në proceset e ardhshme tarifore, veçanërisht në drejtim të saktësisë së planifikimit, arsyetimit të ndryshimeve dhe kontrollit të shpenzimeve operative.

Sa i përket mirëmbajtjes kapitale nga të hyrat vetanake, Figura 13 tregon një diferencë të konsiderueshme në nivelin e realizimit ndërmjet KRU-ve. Në vitin 2025, KRU "Gjakova" ka shënuar nivelin më të lartë të realizimit me 115%, duke tejkaluar nivelin e planifikuar, pasuar nga KRU "Bifurkacioni" me 75%, KRU "Hidroregjioni Jugor" me 66% dhe KRU "Prishtina" me 68%, të cilat kanë shënuar nivel realizimi mbi mesataren e sektorit, perderisa, KRU "Hidromorava" me 44%, KRU "Hidrodrini" me 29% dhe KRU "Mitrovica" me vetëm 11% kanë paraqitur nivel dukshëm më të ulët të realizimit në raport me planifikimin.

Në krahasim me vitin 2024, shumica e KRU-ve kanë shënuar përmirësim në realizimin e mirëmbajtjes kapitale, me përjashtim të KRU "Hidrodrini", e cila ka shënuar rënie të theksuar, nga 140% sa ishte në vitin 2024 në 29% në vitin 2025. Ky ndryshim tregon një reduktim të konsiderueshëm të aktiviteteve të realizuara në këtë kategori gjatë vitit 2025.

Duke pasur parasysh se mirëmbajtja kapitale lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e gjendjes së aseteve, funksionalitetin e rrjetit dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ujësjellësit, nivelet e ulëta të realizimit kërkojnë vëmendje të veçantë në planifikimin dhe menaxhimin e mjeteve në dispozicion. Në këtë kontekst, realizimi mbi nivelin e planifikuar nuk konsiderohet në vetvete si performancë negative, pasi mund të jetë rezultat i nevojave shtesë për ndërhyrje dhe mirëmbajtje të infrastrukturës, përderisa këto shpenzime janë të arsyetuara dhe lidhen me nevojat reale të shërbimit. Për këtë arsye, mirëmbajtja kapitale mbetet një aspekt i rëndësishëm në vlerësimin e performancës së KRU-ve.

Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është një tregues i rëndësishëm financiar që mat shpenzimet mesatare të KRU-së për prodhimin e një metri kub (1 m³) uje. Ky tregues mundëson vlerësimin e nivelit të kostos së prodhimit dhe efikasitetit të shpenzimeve operative, si dhe ofron bazë për analizimin e ndryshimeve të kostos ndërmjet KRU-ve dhe identifikimin e mundësive për optimizimin dhe reduktimin e shpenzimeve.




Figura 14. Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë 2025 në raport me vitin 2024

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare për njësi e ujit të prodhuar është rritur në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, duke treguar rritje të shpenzimeve mesatare të nevojshme për prodhimin e një metri kub uje. Kjo rritje kërkon vëmendje të veçantë në aspektin e efikasitetit të kostove operative dhe menaxhimit të procesit të prodhimit.

Kostot për njësi në vitin 2025, në shumicën e KRU-ve, ishin më të larta krahasuar me vitin 2024, me përjashtim

të KRU "Hidroregjioni Jugor" dhe KRU "Hidrodrini", të cilat kanë shënuar ulje të kostos për njësi krahasuar me vitin paraprak.

Ulja më e theksuar e kostos për njësi është evidentuar të KRU "Hidroregjioni Jugor", e cila lidhet kryesisht me rritjen e konsiderueshme të sasisë së ujit të prodhuar nga kjo kompani. Në vitin 2025, kjo kompani ka raportuar rritje prej 13% të sasisë së ujit të prodhuar krahasuar me vitin 2024, duke ndikuar në uljen e kostos mesatare për njësi.

Në anën tjetër, të KRU "Mitrovica" dhe KRU "Hidromorava", kostot për njësi rezultojnë dukshëm më të larta dhe ndikohen kryesisht nga niveli i lartë i shpenzimeve të energjisë elektrike, si dhe nga shpenzimet për materiale dhe materie të konsumueshme.

Në përgjithësi, niveli i kostos për njësi ndërlidhet me disa faktorë, ndër të cilët veçohen shpenzimet e energjisë elektrike dhe shpenzimet e personelit. Gjithashtu, niveli i humbjeve të ujit përbën një faktor të rëndësishëm në vlerësimin e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit, pasi humbjet e larta nënkuptojnë nevojën për prodhimin e sasive më të mëdha të ujit për të realizuar të njëjtin nivel të ujit të faturuar. Në këtë kuadër, për çdo 1 m³ ujë të shitur, nevojitet prodhimi mesatarisht i 2.27 m³ ujë, çka tregon ndikimin e humbjeve të ujit në efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë

Kostoja totale për njësi për aktivitetet e furnizimit me ujë (kostot operative plus mirëmbajtja kapitale, por duke përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija3), është paraqitur në Figurën 15.




Figura 15. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë (€ për m3 ujë të shitur)

Në vitin 2025, në nivel sektori, kostoja për njësi e furnizimit me ujë ishte 0.46 €/m³, duke shënuar rritje prej 0.05 €/m³ ose 11%, krahasuar me vitin 2024.

Siç shihet në figurë, ekziston një shpërndarje e gjerë në nivel te kompanive sa i përket kostos totale për njësi të ujit të shitur dhe e cila ndryshon nga shpërndarja e kostos për njësi të ujit të prodhuar.

KRU 'Hidrodrini' ka nivelin më të ulët të kostos së ujit të shitur krahasuar me të gjitha kompanitë tjera me 0.32 €/m³, deri tek ajo më e larta që është për KRU "Hidroregjioni Jugor', me 0,66 €/m³.

Një rritje e theksuar e kostos për njësi është vërejtur tek KRU "Hidroregjioni Jugor", ku nga 0.49 €/m³ në vitin 2024 ka arritur në 0.66 €/m³ në vitin 2025 – një rritje prej 35%, lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve operative për furnizim me ujë, me theks shpërndarja e shpenzimeve jo adekuate ne mes të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Edhe KRU 'Prishtina' dhe KRU "Hidromorava" kanë pasur rritje të kostos së ujit të shitur me të lartë në raport

[3] Në përputhje me Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit borxhet e këqija në këtë raport janë të definuara si shuma e të ardhurave të pa-arkëtuara nga viti paraprak.

me vitin paraprak dhe atë për 19%, kjo rritje e kostos në këtë rast i atribuohet kryesisht rritjes së shpenzimeve të energjisë dhe rritjes se shpenzimeve të materialit dhe materieve të konsumueshme. Përderisa tek KRU 'Hidroregjioni Jugor' rritja është shkaktuar si rezultat i rritjes së shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit.

3.2.6. Investimet kapitale për ujësjellës

Përmes proceseve tarifore, ARRU, në baza vjetore, aprovon shuma të konsiderueshme të mjeteve financiare për KRU-të, të dedikuara për investime kapitale në mirëmbajtjen dhe përtëritjen e aseteve, të vlerësuara si të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë. Po ashtu, KRU-të, përmes Planeve të Biznesit Rregullator, planifikojnë mjete të konsiderueshme për investime të financuara nga donacionet, përkatësisht grantet e institucioneve qeveritare dhe donatorëve, të cilat kontribuojnë në mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit.

Tabela 4. Investimet e realizuara dhe të planifikuara nga të hyrat vetanake

Burimet vetanake të investimit					
KRU	**2024**	**2025**			**% krahasuese: 2025/2024 (realizim)**
	Investimet kapitale (realizuar)	**Investimet kapitale (planifikim)**	**Investimet kapitale (realizim)**	**% krahasuese 2025: realizim/ planifikim**	
PR	762,012	3,701,450	605,895	16.4%	-20%
PZ	691,741	715,325	954,709	133.5%	38%
PE	1,169,117	710,000	437,717	61.7%	-63%
MIT	116,999	555,767	33,629	6.1%	-71%
GJA	666,116	983,650	1,184,458	120.4%	78%
FE	310,425	449,000	441,753	98.4%	42%
GJI	421,796	503,120	261,352	51.9%	-38%
Sektori	**4,138,206**	**7,618,312**	**3,919,514**	**51.4%**	**-5%**

Në vitin 2025, përmes procesit tarifor, në nivel sektori ishin aprovuar gjithsej rreth 7.62 mil. € për kostot kapitale në shërbimin e furnizimit me ujë, që paraqet një vlerë për 218,692 € më të ulët krahasuar me vitin 2024. Nga kjo shumë, janë realizuar rreth 3.92 mil. €, apo 51.4% e shumës së aprovuar.




Figura 16. Shpenzimet kapitale aktuale nga të hyrat vetanake/shpenzimet kapitale të planifikuara

Përqindjen më të lartë të realizimit të investimeve kapitale nga burimet vetanake, në raport me planin për vitin 2025, e ka realizuar KRU "Hidroregjioni Jugor" me 133.5%, e pasuar nga KRU "Gjakova" me 120.4% dhe KRU "Bifurkacioni" me 98.4%. Megjithatë, krahasuar me vitin paraprak, vërehet një rënie në nivelin e realizimit të investimeve kapitale. Përqindja e lartë e ndryshimit të realizimit në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 për

KRU "Gjakova" duhet të interpretohet me kujdes, pasi në vitin 2024 vlera e investimeve të realizuara nga kjo KRU ka qenë relativisht e ulët.

Mungesa e investimeve, veçanërisht e atyre të dedikuara për mirëmbajtjen dhe ripërtëritjen e aseteve kapitale, mund të ndikojë në përkeqësimin e bazës së aseteve dhe në nivelin e shërbimit. Kjo mund të shoqërohet me rritje të numrit të defekteve në rrjet dhe ruajtjen e niveleve të larta të humbjeve të ujit në sistemin shpërndarës.

Tabela 5. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet

KRU	Investimet prej granteve				% Krahasuese: 2025/2024 (Realizim)
	2024	2025			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% Krahasuese 2025: realizim/ planifikim	
PR	169,786	-	-	/	-100%
PZ	156,051	-	782,971	#DIV/0!	402%
PE	150,000	-	1,797,875	-	1099%
MIT	39,237	-	56,545	-	44%
GJA	12,478	-	1,882,865	#DIV/0!	14989%
FE	479,352	-	57,118	#DIV/0!	-88%
GJI	606,414	-	-	#DIV/0!	-100%
Sektori	**1,613,318**	**-**	**4,577,374**	**#DIV/0!**	**184%**

Në vitin 2025, investimet kapitale të realizuara nga grantet e donatorëve në nivel sektori kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2024. Vlera totale e investimeve të realizuara nga grantet është rritur nga rreth 1.61 mil. € në vitin 2024 në rreth 4.58 mil. € në vitin 2025, duke shënuar një rritje prej rreth 184%. Kjo rritje pasqyron një angazhim më të madh të burimeve të jashtme në financimin e investimeve kapitale në sektorin e shërbimeve të ujësjellësit.

Në vitin 2025, vlerën më të lartë të investimeve të realizuara nga grantet e ka KRU "Gjakova", me rreth 1.90 mil. €, e pasuar nga KRU "Hidrodrini" me rreth 1.80 mil. € dhe KRU "Hidroregjioni Jugor" me rreth 0.780 mil. €. Ndërkohë, KRU "Prishtina" dhe KRU "Hidromorava" nuk kanë realizuar investime nga grantet gjatë vitit 2025, ndërsa investimet e realizuara nga KRU "Mitrovica" dhe KRU "Bifurkacioni" kanë qenë relativisht të ulëta.

Duhet të theksohet se në vitin 2025 nuk janë paraqitur vlera të planifikuara për investimet e financuara nga grantet, andaj përqindja e realizimit ndaj planit nuk mund të llogaritet dhe paraqitet si e papërcaktuar në tabelë. Për këtë arsye, rritja e realizimit të investimeve nga grantet duhet të vlerësohet në bazë të vlerave faktike të realizuara dhe jo në raport me planin.

Tabela 6. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet

	Burimet vetanake të investimit + grantet				
	2024	2025			% krahasuese: 2025/2024 (realizim)
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% Krahasuese 2025: realizim/ planifikim	
Sektori-Investime Vetanake	4,138,206	7,618,312	3,919,514	51.45%	-5%
Sektori-Investime Grante	1,613,318	-	4,577,374	#DIV/0!	184%
Sektori	**5,751,525**	**7,618,312**	**8,496,889**	**111.5%**	**48%**

Nga tabela 6 vërehet se realizimi i investimeve kapitale në vitin 2025, në nivel sektori nga mjetet vetanake dhe donacionet ishte me i lartë se në vitin e kaluar për rreth 2.75 mil. €.




Figura 17. Shpenzimet kapitale të realizuara nga te hyrat vetanake dhe grantet ne raport me planifikimet

Nga totali i investimeve kapitale (të financuara nga të hyrat vetanake dhe grantet) në shërbimin e furnizimit me ujë, në nivel të sektorit është realizuar mesatarisht 111.5% nga planifikimi. Nivele më të larta të realizimit kanë shënuar KRU "Hidrodrini", "Gjakova", "Hidroregjioni Jugor" dhe "Bifurkacioni". Ky nivel i lartë i realizimit lidhet kryesisht me faktin se këto KRU nuk kishin planifikuar investime të financuara nga grantet, duke e bërë bazën e planifikimit relativisht të ulët. Për rrjedhojë, realizimi faktik i investimeve ka tejkaluar nivelin e planifikuar.

3.3. Përformanca operative - shërbimet e ujërave të ndotura

Ky nën-kapitull analizon performancën e shtatë KRU në lidhje me shërbimet për ujërat e zeza për vitin 2025 dhe e krahason performancën e vitit 2025 me atë të vitit 2024 dhe kundrejt caqeve / pritjeve që janë të përfshira në procesin tarifor 2022-2025. Sikurse për furnizimin me ujë ne ndajmë këtë analizë në tri sesione kryesore: jo-financiare (teknike), jo-financiare (komerciale) dhe financiare.

3.3.1. Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Në vitet e fundit, trajtimi i ujërave të ndotura është bërë një nga prioritetet e investimeve të institucioneve vendore dhe donatorëve ndërkombëtarë. Deri në fund të vitit 2025, në Kosovë janë në funksion gjashtë impiante për trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN), të cilat menaxhohen nga KRU-të përkatëse.

Këto impiante përfshijnë ITUN-in në Skënderaj, i cili trajton ujërat e ndotura të vendbanimeve Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm dhe Tërnavc dhe menaxhohet nga KRU Mitrovica; ITUN-et në Mramor dhe Harilaç, të cilat trajtojnë ujërat e ndotura të këtyre dy vendbanimeve dhe menaxhohen nga KRU Prishtina; ITUN-in në Prizren, i cili mbulon një pjesë të zonës urbane të qytetit dhe menaxhohet nga KRU Hidroregjioni Jugor; ITUN-in në Pejë, i cili trajton ujërat e ndotura të një pjese të qytetit dhe të vendbanimit Qyshk dhe menaxhohet nga KRU Hidrodrini; si dhe ITUN-in në Gjakovë, i cili mbulon një pjesë të zonës urbane dhe menaxhohet nga KRU Gjakova.

Në kuadër të këtyre impianteve janë ndërtuar laboratorë të pajisur me teknologji moderne dhe janë angazhuar staf profesional i trajnuar për kryerjen e analizave dhe monitorimin e cilësisë së ujërave të ndotura. Megjithatë, laboratorët ende nuk janë të akreditуar nga agjencia përgjegjëse për akreditim në Kosovë. Për të garantuar besueshmërinë dhe njohjen zyrtare të rezultateve laboratorike, rekomandohet që agjencitë projekt-zbatuese dhe donatorët të përfshijnë në mbështetjen e tyre edhe procesin e akreditimit të laboratorëve, si dhe certifikimin dhe avancimin profesional të personelit laboratorik.

Rezultatet e analizave laboratorike tregojnë se shumica e testeve janë brenda standardeve vendore ku prej 4,945 mostrave 52 prej tyre nuk janë ne përputhje me vlerat e lejuara sipas standardeve.

3.3.2. Performanca e rrjetit të kanalizimit

Matja kryesore e besueshmërisë së shërbimit të grumbullimit të ujërave të ndotura vlerësohet përmes numrit të bllokimeve dhe vërshimeve në rrjetin e kanalizimit. Për qëllime të krahasimit të performancës ndërmjet KRU-ve dhe ndër vite, ky tregues shprehet zakonisht si numri i bllokimeve për 100 km të rrjetit të kanalizimit në vit.




Figura 18. Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit

Rezultatet e raportuara për vitet 2024 dhe 2025 tregojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet KRU-ve sa i përket numrit të bllokimeve për 100 km të rrjetit të kanalizimit. Në vitin 2025 vlerat variojnë nga 192 bllokime për 100 km në KRU Bifurkacioni deri në 710 në KRU Gjakova.

Krahasuar me vitin 2024, gjatë vitit 2025 ulje të numrit të bllokimeve kanë shënuar KRU Gjakova, Hidrodrini,

dhe KRU Prishtina, ku përmirësimi më i theksuar është evidentuar në KRU Hidrodrini, nga 827 në 496 bllokime për 100 km. Ndërsa rritje janë evidentuar në KRU Mitrovica, Hidroregjioni Jugor, Hidromorava dhe KRU Bifurkacioni, me rritjen më të theksuar në KRU Hidroregjioni Jugor, nga 256 në 561 bllokime për 100 km,

Megjithëse nuk ekziston një pikë referimi e unifikuar për një nivel të kënaqshëm të bllokimeve, vlerat e larta dhe ndryshimet ndërmjet KRU-ve tregojnë nevojën për forcimin e mirëmbajtjes preventive dhe rehabilitimin e rrjetit. Përmirësimi i besueshmërisë së shërbimit kërkon një qasje më proaktive, përmes identifikimit të segmenteve problematike, mirëmbajtjes së rregullt dhe planifikimit të investimeve për rehabilitimin e rrjetit.

3.4. Performanca komerciale dhe financiare – shërbimet e ujërave të ndotura

Ky nën-sesion fokusohet në aspektet komerciale të ujërave të zeza të tilla si: mbulueshmëria me shërbime dhe ankesat me fokusim në ato aspekte që ndikojnë drejtpërdrejtë në konsumatorë.

3.4.1. Mbulueshmëria me shërbime

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është e definuar si përqindje e popullsisë, brenda zonës së shërbimit, që kanë shërbime të kanalizimit nga KRU.




Figura 19. Mbulueshmëria me shërbimet e ujëra të ndotura

Gjatë vitit 2025, mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimit) në nivel sektori është rritur për 1% krahasuar me vitin 2024, duke u rritur nga 69% në 70%.

Në nivel individual të KRU-ve, përmirësimi më i theksuar është evidentuar te KRU Hidromorava, nga 57% në 60%.

KRU Hidrodrini vazhdon të ketë nivelin më të ulët të mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimit) në sektor. Në vitin 2025, mbulueshmëria ka mbetur e pandryshuar në 52%, në të njëjtin nivel me vitin 2024, duke e renditur këtë KRU në pozitën më të dobët sa i përket mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit.

Ndërkaq, KRU Prishtina, Gjakova dhe KRU Bifurkacioni kanë ruajtur nivelin e njëjtë të mbulueshmërisë, duke u renditur ndër KRU-të me performancën më të mirë.

3.4.2. Ankesat

Treguesi i mëposhtëm paraqet numrin e ankesave që konsumatorët i drejtojnë kompanive të tyre, lidhur me shërbimin e ujërave të ndotura. Në këtë shifër janë përfshirë vetëm ankesat me natyrë teknike.

Tabela 7. Ankesat e konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura

KRU	Ankesat teknike	
	2024	**2025**
PR	3,668	3,966
PZ	557	612
PE	3,484	3,066
MIT	1,320	3
GJA	229	390
FE	1	3
GJI	3	0
Sektori	**9,262**	**8,040**

Menaxhimi i ankesave për shërbimin e ujërave të ndotura në disa KRU vazhdon të ketë nevojë për përmirësim. Të dhënat e raportuara për vitet 2024 dhe 2025 tregojnë ndryshime të mëdha ndërmjet KRU-ve dhe ndër vite, gjë që mund të lidhet edhe me mënyrën e regjistrimit, klasifikimit dhe raportimit të ankesave. Në nivel sektori, numri i ankesave ka rënë nga 9,262 në vitin 2024 në 8,040 në vitin 2025.

Ndryshimet më të theksuara janë evidentuar në KRU Prishtina, ku ankesat janë rritur nga 3,668 në 3,966, si dhe në KRU Hidroregjioni Jugor, ku janë rritur ndjeshëm nga 557 në 612 ankesa, ndërsa në KRU Hidrodrini kanë rënë nga 3,484 në 3,066, ulje është evidentuar edhe në KRU Mitrovica. Në KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidromorava numri i ankesave të raportuara mbetet shumë i ulët.

Për të rritur besueshmërinë e këtij treguesi, KRU-të duhet të sigurojnë regjistrim, klasifikim dhe mirëmbajtje të rregullt të të dhënave për ankesat, në përputhje me kërkesat e ARRU-së. Përdorimi efektiv dhe përditësimi i vazhdueshëm i sistemeve CRM do të mundësonte evidentim më të saktë të ankesave dhe përmirësim të cilësisë së menaxhimit dhe raportimit të tyre.

3.4.3. Shitjet në vlerë monetare

Vlera e shitjeve për shërbimet e ujërave të zeza është e lidhur drejtpërdrejt me volumin e shitjeve të ujit. Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve të ujit nga disa prej KRU-ve, krahasuar me nivelet e planifikuara, edhe vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura ka rezultuar nën nivelin e planifikuar. Kjo ndërlidhje reflektohet në rezultatet e paraqitura në Figurën 20.




Figura 20. Shitjet e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me shitjet e planifikuara sipas procesit tarifor 2025

Në nivel të sektorit, realizimi i shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me planifikimin ka shënuar rënie në vitin 2025, duke arritur në 91%, krahasuar me 97% në vitin 2024. Kjo tregon se, pavarësisht objektivave të planifikuara, në vitin 2025 shumica e KRU-ve nuk kanë arritur nivelin e planifikuar të shitjeve.

Nga KRU-të, "Mitrovica" ka shënuar realizimin më të lartë në vitin 2025, me 116% të planifikimit, duke tejkaluar objektivin e planifikuar. Pas saj renditet "Bifurkacioni", me 101%, duke realizuar gjithashtu mbi nivelin e planifikuar. Ndërsa KRU "Hidroregjioni Jugor" ka realizuar 94% të planifikimit, "Prishtina" 93%. Nivele më të ulëta të realizimit kanë shënuar KRU "Gjakova" 88% "Hidromorava", me 86%, dhe "Hidrodrini", me 76% të planifikimit.

Në krahasim me vitin 2024, shumica e KRU-ve kanë shënuar rënie në realizimin e shitjeve në raport me planifikimin. Rëniet më të theksuara vërehen të KRU "Hidrodrini", nga 100% në 76%, dhe të "Hidromorava", nga 93% në 86%. Në anën tjetër, "Mitrovica" ka shënuar përmirësim. Këto rezultate tregojnë nevojën për vëmendje të mëtejshme në realizimin e objektivave të shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura dhe në përmirësimin e performancës komerciale.

3.4.4. Vlera relative e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura

Vlera monetare e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura paraqet një komponent të rëndësishëm të të ardhurave operative të KRU-ve dhe ndikon drejtpërdrejt në gjendjen e tyre financiare. Në vitin 2025, kjo vlerë, ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar përmirësim të performancës financiare, kryesisht si rezultat i zgjerimit të bazës së faturimit, të ndikuar nga rritja e numrit të konsumatorëve.




Figura 21. Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë 2025 në raport me vitin 2024

Gjatë vitit 2025, shitjet e shërbimeve të ujërave të ndotura kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2024. Rritja më e madhe është evidentuar të KRU "Hidromorava", me 46.7%, pasuar nga KRU "Mitrovica" me 40% dhe KRU "Prishtina" me 36.9%. Edhe KRU-të e tjera kanë shënuar rritje, ndonëse më të moderuar, që varion nga 5.6% deri në 18.5%.

Në nivel të sektorit, vlera monetare e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura është rritur me 19%, duke kaluar nga 6.8 milionë euro në vitin 2024 në 8.2 milionë euro në vitin 2025. Kjo rritje tregon një përmirësim të të hyrave nga ky shërbim në nivel sektori.

Për dallim nga shërbimet e furnizimit me ujë, në shërbimet e ujërave të ndotura KRU "Gjakova" ka shënuar rënie të shitjeve prej 2% krahasuar me vitin 2024. Kjo rënie i atribuohet kryesisht uljes së shitjeve volumetrike të shërbimeve të ujërave të ndotura, pavarësisht rritjes së bazës së konsumatorëve.

3.4.5. Kostot për njësi

Kostot për njësi janë analizuar përmes dy treguesve kryesorë:

- Kostot operative dhe mirembajtja kapitale në raport me planifikimet,
- Kostoja operative për shërbimin e ujërave të ndotura.

Të dhënat statistikore për secilin nga këta tregues paraqiten në figurat në vijim.

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura paraqet koston mesatare vjetore të nevojshme për ofrimin e shërbimit për një konsumator shtëpiak të shërbyer4, duke përfshirë kostot operative dhe mirëmbajtjen kapitale.

[4] Konsumatorët shtëpiak të shërbyer përfshijnë numrin aktual të konsumatorëve shtëpiakë, si dhe konsumatorët jo-shtëpiakë të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiakë. Konvertimi i konsumatorëve jo-shtëpiakë bëhet në bazë të pjesëmarrjes së tyre proporcionale në konsumin e përgjithshëm të ujit.




Figura 22. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura (euro/kons. në vit)

Kostot për njësi për vitet 2025 dhe 2024 janë paraqitur në Figurën 22. Këto kosto për njësi mbeten relativisht të ulëta krahasuar me kostot e shërbimeve të ujërave të ndotura në shumë ekonomi perëndimore, kryesisht për shkak të faktit se në shumicën e KRU-ve ende nuk janë përfshirë shpenzimet për trajtimin e ujërave të ndotura. Përjashtim bëjnë KRU "Hidroregjioni Jugor", KRU "Hidrodrini" dhe KRU "Gjakova", të cilat kanë filluar ofrimin e shërbimit të trajtimit të ujërave të ndotura.

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare për konsumatorë për shërbimin r ujërave të ndotura në vitin 2025 ka shënuar rritje prej 24% krahasuar me vitin 2024, duke u rritur nga 12.01 euro/kons. /vit në 14.84 euro/kons. /vit. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së konsiderueshme të shpenzimeve totale për shërbimin e ujërave të ndotura, veçanërisht te KRU "Hidrodrini" dhe KRU "Gjakova". Rritja e kostove ka qenë më e theksuar sesa rritja e bazës së konsumatorëve, duke rezultuar në rritjen e kostos mesatare për njësi në nivel të sektorit.

Kostot operative dhe mirembajtja kapitale në raport me planifikimet

Kostot operative, përfshirë mirëmbajtjen kapitale (përtëritjen e infrastrukturës dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale) për shërbimet e ujërave të ndotura në raport me planifikimet paraqesin një nga treguesit financiarë që bëjnë pjesë në grupin e treguesve kyç të performancës, përmes të cilëve vlerësohet niveli i performancës së shërbimeve të ujërave të ndotura. Ky tregues paraqet raportin ndërmjet kostove të realizuara, përkatësisht shpenzimeve operative të realizuara, përfshirë mirëmbajtjen kapitale, dhe kostove të planifikuara. Përmes këtij treguesi vlerësohet shkalla e realizimit të kostove në raport me planifikimet përkatëse.




Figura 23. Shpenzimet operative dhe mirembajtja kapitale për ujëra të ndotura e realizuar në raport me planin

Realizimi më i lartë i shpenzimeve operative ndaj planit është evidentuar të KRU "Prishtina", me 178%, pasuar nga KRU "Gjakova" me 129%, pastaj edhe të KRU "Mitrovica" me 109%. Ndërkohë, KRU "Hidromorava", "Hidroregjioni Jugor", "Bifurkacioni" dhe "Hidrodrini" kanë realizuar shpenzime operative në nivele më të ulëta se ato të planifikuara. Edhe pse këto KRU kanë realizuar nivele shumë më të ulëta të shpenzimeve operative sesa kanë planifikuar, nuk përbën domosdoshmërisht tregues të menaxhimit më efikas të shpenzimeve. Realizimi dukshëm nën nivelin e planifikuar mund të tregojë se shpenzimet dhe aktivitetet e planifikuara nuk janë realizuar sipas parashikimeve, duke reflektuar mangësi në planifikimin dhe menaxhimin e burimeve nga ana e KRU-ve. Për këtë arsye, menaxhmenti i KRU-ve duhet të sigurojë që planet e shpenzimeve të bazohen në nevoja reale dhe në aktivitetet që planifikohen të realizohen gjatë vitit, si dhe të monitorojë në vazhdimësi përputhjen e realizimit me planifikimin e miratuar.

Në këtë kuadër, si tejkalimi i konsiderueshëm i shpenzimeve të planifikuara, ashtu edhe mosrealizimi i dukshëm i tyre, paraqesin devijime që kërkojnë analizë dhe arsyetim nga menaxhmenti i KRU-ve, si dhe masa për përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të shpenzimeve në periudhat pasuese.

Sa i përket mirëmbajtjes kapitale të financuara nga të hyrat vetanake, Figura 22 tregon një diferencë të konsiderueshme në nivelin e realizimit ndërmjet KRU-ve. Në vitin 2025, KRU "Bifurkacioni" ka shënuar nivelin më të lartë të realizimit, me 45%, megjithëse edhe ky nivel mbetet dukshëm nën nivelin e planifikuar. Ndërkohë, disa KRU kanë paraqitur nivele edhe më të ulëta të realizimit në raport me planifikimin, duke rezultuar në një mesatare të realizimit në nivel sektori prej vetëm 12%.

Duke pasur parasysh se mirëmbajtja kapitale lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e gjendjes së aseteve, funksionalitetin e rrjetit dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ujërave të ndotura, nivelet e ulëta të realizimit kërkojnë vëmendje të veçantë nga menaxhmenti i KRU-ve. Nëse shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtje kapitale janë të bazuara në nevoja reale dhe të arsyetuara, mosrealizimi i tyre në masë të konsiderueshme paraqet devijim negativ, pasi mund të ndikojë në mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e aseteve dhe, rrjedhimisht, në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve.

Për këtë arsye, KRU-të duhet të sigurojnë që planifikimi i mirëmbajtjes kapitale të jetë realist, dhe të bazohet në gjendjen dhe nevojat e aseteve, si dhe të ndërmarrin masat e nevojshme për realizimin e aseteve të planifikuara. Njëkohësisht, çdo nivel i ulët i realizimit ndaj planit duhet të analizohet dhe arsyetohet nga menaxhmenti i KRU-së, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndërhyrje të planifikuara që lidhen me ruajtjen e funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së infrastrukturës.

3.4.6. Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Me procesin tarifor për vitin 2025, ARRU ka aprovuar investime kapitale (mirëmbajtje kapitale dhe rritje kapitale) me qëllim qe KRU të sigurojnë nivele më të kënaqshme të shërbimit të ujërave të ndotura.

Tabela 8. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake

Burimet vetanake të investimit					
KRU	**2024**	**2025**			
	Investimet kapitale (realizuar)	**Investimet kapitale (planifikim)**	**Investimet kapitale (realizim)**	**% krahasuese 2025: realizim / planifikim**	**% krahasuese: 2025 / 2024**
PR	68,848	589,000	134,493	22.8%	95%
PZ	103,396	237,516	54,600	23.0%	-47%
PE	151,362	520,000	331,375	63.7%	119%
MIT	12,250	139,807	1,966	1.4%	-84%
GJA	11,430	160,000	6,297	3.9%	-45%
FE	214,540	245,000	106,852	43.6%	-50%
GJI	53,866	116,727	5,084	4.4%	-91%
Sektori	**615,692**	**2,008,050**	**640,666**	**31.9%**	**4%**

KRU-të, në total, nga të hyrat vetanake kishin planifikuar rreth 2.0 milionë euro investime në shërbimin e ujërave të ndotura, ndërsa janë realizuar vetëm 31.9% e vlerës së planifikuar. Investimet kapitale të realizuara në vitin 2025 në infrastrukturën e ujërave të ndotura kanë arritur në rreth 0.641 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 4% krahasuar me vitin 2024.

Megjithatë, pavarësisht kësaj rritjeje, niveli i investimeve mbetet shumë i ulët në raport me gjendjen ekzistuese të infrastrukturës dhe nevojat për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimit të ujërave të ndotura. Të gjitha KRU-të kanë realizuar investime nën vlerat e planifikuara, çka tregon për një nivel të ulët të realizimit të planeve investive në këtë sector, duke nxjerrë në pah nevojën për vëmendje të mëtejshme nga ana e KRU-ve.




Figura 24. Shpenzimet kapitale aktuale nga të hyrat vetanake/shpenzimet kapitale të planifikuara

Në mesin e KRU-ve, "Hidrodrini" ka shënuar nivelin më të lartë të realizimit të investimeve në raport me planifikimin, me 63.7%, ndonëse edhe ky nivel mbetet nën shumën e planifikuar.

Tabela 9. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet

	Investimet prej granteve				
	2024	2025			
KRU	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2025: realizim/ planifikim	% krahasuese: 2025/2024
PR	7,049	-	-	#DIV/0!	-100%
PZ	4,213,032	-	18,430,164	#DIV/0!	337%
PE	140,970	-	19,069,228	#DIV/0!	13427%
MIT	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
GJA	505	-	-	#DIV/0!	-100%
FE	3,800	-	-	#DIV/0!	-100%
GJI	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Sektori	**4,365,356**	**-**	**37,499,391**	**#DIV/0!**	**759%**

Për vitin 2025, KRU-të nuk kishin planifikuar asnjë investim të financuar nga grantet, qoftë nga institucionet qeveritare apo nga donatorët. Megjithatë, gjatë vitit janë realizuar investime në vlerë prej rreth 37.5 milionë euro, e të cilat janë realizuar vetëm nga KRU "Hidrodrini" dhe KRU "Hidroregjioni Jugor".

Duke pasur parasysh se këto investime nuk kanë qenë të planifikuara për vitin 2025, realizimi i tyre gjatë këtij viti lidhet me investime të projektuara në vitet paraprake, të cilat kanë qenë në vazhdimësi dhe janë përfunduar dhe pranuar teknikisht gjatë vitit 2025. Si rrjedhojë, vlera e tyre është regjistruar në kontabilitet si investim i realizuar gjatë vitit 2025.

Pavarësisht kësaj, vlera e lartë e investimeve të realizuara nga këto dy KRU ka ndikuar që sektori, në tërësi, të shënojë trend pozitiv në realizimin e investimeve kapitale krahasuar me vitin 2024.

Tabela 10. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet

	Burimet vetanake të investimit + grantet				
	2024	2025			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% Krahasuese 2025: realizim/ planifikim	% Krahasuese: 2025/2024
Sektori-Investime Vetanake	615,692	2,008,050	640,666	31.9%	4%
Sektori-Investime Grante	4,365,356	-	37,499,391	#DIV/0!	759%
Total Sektori	**4,981,048**	**2,008,050**	**38,140,058**	**1899.36%**	**666%**

Në total, në sektorin e shërbimeve të ujërave të ndotura, nga investimet e financuara përmes mjeteve vetanake të KRU-ve dhe granteve, gjatë vitit 2025 janë realizuar rreth 38 milionë euro investime. Projektet përkatëse ishin planifikuar dhe iniciuar në vitet paraprake, ndërsa pas përfundimit dhe pranimit teknik gjatë vitit 2025, vlera e tyre është regjistruar në kontabilitet si investim i realizuar gjatë këtij viti.




Figura 25. Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura ne raport me planifikimin

Nga totali i investimeve kapitale, të financuara nga të hyrat vetanake dhe grantet, në shërbimin e ujërave të ndotura, në nivel të sektorit është realizuar 1,899% e vlerës së planifikuar. Nivele veçanërisht të larta të realizimit kanë shënuar KRU "Hidrodrini" dhe KRU "Hidroregjioni Jugor". Këto nivele jashtëzakonisht të larta të realizimit lidhen kryesisht me faktin se këto KRU nuk kishin planifikuar investime të financuara nga grantet për vitin 2025, duke e bërë bazën e planifikimit relativisht të ulët. Si rezultat, realizimi faktik i investimeve, përfshirë investimet e projektuara dhe të iniciuara në vitet paraprake, ka bërë që përqindja e realizimit të jetë jashtëzakonisht e lartë në raport me vlerën e planifikuar për vitin 2025.

3.5. Performanca financiare për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura

3.5.1. Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave

Në vijim paraqitet performanca e KRU-ve lidhur me treguesin e shkallës së arkëtimit për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024. Ky tregues është llogaritur si raport ndërmjet mjeteve monetare të arkëtuara (cash) dhe faturimit të rregullt për shërbimet e ofruara të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, duke përjashtuar taksat e kyçjes dhe të ardhurat e tjera operative.

Shkalla e arkëtimit është një nga treguesit kryesorë të performancës financiare të KRU-ve, pasi pasqyron aftësinë e kompanisë për të arkëtuar të hyrat e faturuara nga shërbimet e ofruara. Niveli i këtij treguesi ndikon drejtpërdrejt në disponueshmërinë e mjeteve monetare dhe në aftësinë e kompanisë për të përmbushur detyrimet e saj financiare dhe për të financuar operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve. Në këtë kuptim, një nivel më i lartë i arkëtimit kontribuon në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të kompanisë.




Figura 26. Efiçienca në arkëtimin e të ardhurave[5]

Niveli aktual i shkallës së arkëtimit prej 102% është 2% më e ulët krahasuar me vitin 2024. Rënia është evidentuar pothuajse në të gjitha KRU-të, megjithatë, shkalla e arkëtimit vazhdon të jetë në nivel të lartë në nivel sektorial, duke treguar se kompanitë, përveç arkëtimit të faturimit aktual, kanë vazhduar të arkëtojnë edhe detyrimet e mbetura nga periudhat paraprake.

Sikurse në vitin paraprak, edhe në vitin 2025 KRU "Hidromorava" ka shënuar shkallën më të lartë të arkëtimit krahasuar me KRU-të e tjera, duke arritur nivelin prej 107%. Ky rezultat lidhet kryesisht me nivelin e lartë të arkëtimit të faturave të papaguara nga konsumatorët shtëpiakë, i cili ka kompensuar nivelin më të ulët të arkëtimit nga konsumatorët jo-shtëpiakë. Në përgjithësi, shumica e KRU-ve kanë shënuar nivele të larta të arkëtimit, duke reflektuar një performancë të mirë në mbledhjen e të hyrave të faturuara.

Në anën tjetër, KRU "Hidrodrini" ka shënuar shkallën më të ulët të arkëtimit krahasuar me KRU-të e tjera. Ky nivel tregon për sfida në mbledhjen e të hyrave të faturuara dhe paraqet një fushë që kërkon vëmendje të mëtejshme në menaxhimin e arkëtimit dhe në zbatimin e masave për përmirësimin e efikasitetit të mbledhjes së të hyrave.

Në nivel të sektorit, objektivi i përcaktuar në procesin tarifor për vitin 2025 ka qenë 96%, ndërsa shkalla e arkëtimit e realizuar ka arritur në 102%, ose 6% mbi objektivin e planifikuar. Kjo tregon se objektivi sektorial është përmbushur dhe tejkaluar. Megjithatë, KRU "Hidrodrini" mbetet përjashtim, pasi niveli i arkëtimit të saj është nën objektivin e përcaktuar.

[5] Tek llogaritja e efiçiencës së arkëtimit janë përjashtuar të ardhurat nga taksat e kyçjes si dhe të ardhurat tjera

Tabela 11. Shkalla e arkëtimit e realizuar në raport me objektivat

Shkalla e arkëtimit	Realizimi		Planifikimi	
KRU	**2024**	**2025**	**2024**	**2025**
PR	107%	104%	94%	96%
PZ	106%	104%	94%	96%
PE	90%	90%	94%	97%
MIT	100%	100%	88%	96%
GJA	106%	103%	95%	96%
FE	98%	100%	93%	96%
GJI	114%	107%	94%	97%
Sektori	104%	102%	93%	96%

Siç vërehet nga tabela, sektori ka realizuar nivele të arkëtimit mbi objektivin e përcaktuar për dy vite radhazi, me 104% në vitin 2024 dhe 102% në vitin 2025. Edhe pse në vitin 2025 është shënuar një rënie prej 2 % krahasuar me vitin paraprak, niveli i realizimit mbetet mbi objektivin e planifikuar, duke treguar një performancë të qëndrueshme në mbledhjen e të hyrave.

Në këtë rezultat kanë kontribuar veçanërisht KRU "Hidromorava", KRU "Prishtina", KRU "Hidroregjioni Jugor" dhe KRU "Gjakova", të cilat kanë realizuar nivele të larta të shkallës së arkëtimit dhe kanë ndikuar në performancën e përgjithshme të sektorit.

Niveli i lartë i realizimit lidhet kryesisht me inkasimin e faturave nga konsumatorët shtëpiakë, kontribut shtesë në shkallën e përgjithshme të arkëtimit ka pasur edhe arkëtimi nga konsumatorët jo-shtëpiakë, përfshirë konsumatorët industrialë.

Tabela 12. Shkalla e arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2024-2025

Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Amvisëri	111%	108%	107%	107%	91%	91%	104%	107%	108%	103%	101%	104%	117%	113%
Komercial/ industrial	99%	94%	111%	105%	89%	90%	87%	95%	95%	100%	93%	88%	104%	86%
Institucione	100%	102%	91%	81%	84%	85%	88%	56%	107%	123%	56%	79%	93%	77%
Totali	**107%**	**104%**	**106%**	**104%**	**90%**	**90%**	**100%**	**100%**	**106%**	**103%**	**98%**	**100%**	**114%**	**107%**

Nga tabela më lart vërehet se, në shumicën e kompanive, arkëtimi në kategoritë e konsumatorëve industrialë dhe institucionalë vazhdon të paraqesë sfidë dhe kërkon përmirësim. Kjo dallon nga vitet e kaluara, kur sfidat më të theksuara në arkëtim ishin evidentuar kryesisht te kategoria e konsumatorëve shtëpiakë.

Në vitin 2025, KRU "Hidromorava" ka shënuar shkallën më të lartë të arkëtimit te konsumatorët shtëpiakë, me 113%, ndërsa KRU "Hidrodrini" ka shënuar nivelin më të ulët, me 91%. Sa i përket konsumatorëve industrialë, shkallën më të lartë të arkëtimit e ka realizuar KRU "Hidroregjioni Jugor", ndërsa nivelin më të ulët e ka shenuar KRU "Hidromorava", me 86%. Ndërsa, te konsumatorët institucionalë, KRU "Gjakova" prin me shkallën më të lartë të arkëtimit prej 123%, ndërsa KRU "Mitrovica" ka shënuar nivelin më të ulët, me 56%.

Këto rezultate tregojnë se, ndonëse arkëtimi nga konsumatorët shtëpiakë paraqitet në nivele relativisht të larta në shumicën e kompanive, përmirësimi i arkëtimit te konsumatorët industrialë dhe institucionalë mbetet një fushë që kërkon vëmendje dhe masa të mëtejshme nga KRU-të.

3.5.2. Kthimi në kapital

Përmes rishikimit të parë tarifor 2009 - 2011 u fut në përdorim koncepti që KRU të sigurojnë kthimin në kapial, si kusht i domosdoshëm për të arritur një nivel të mjaftueshëm të aftësisë huamarrëse, me qëllim të tërheqjës se investimeve shumë të nevojshme në këtë sektor. Ky koncept është ruajtur edhe në rishikimet tarifore të viteve pasuese, deri në rishikimin tarifor për vitin 2025, ku ARRU ka propozuar një vlerë të kthimit prej 4.25% për

KRU Prishtina dhe 5.25% për gjashtë KRU-të tjera në bazën rregullatore të aseteve (BRRA)[6], pra një normë reale të kthimit në kapital e cila është e bazuar në praktikat e mira të vendeve të Evropës Perëndimore.

Tabela 13. Të dhënat bazë për kalkulimin e kthimit në kapital

KRU	2024				2025			
	Të hyrat[7] a	shpenzimet[8] b	BRRA c	Kthimi në [9]capital (a-b)/c	Të hyrat a	Shpenzimet b	BRRA c	Kthimi në capital (a-b)/c
PR	16,622,645	13,407,846	75,310,818	4.3%	17,417,566	15,937,769	78,187,082	1.9%
PZ	5,761,417	5,215,012	15,328,475	3.6%	6,043,766	6,084,052	16,645,390	-0.2%
PE	4,608,328	5,155,299	14,004,215	-3.9%	5,078,653	4,861,126	15,113,662	1.4%
MIT	4,295,425	4,063,055	8,768,056	2.7%	5,125,266	5,135,667	9,102,505	-0.1%
GJA	5,027,075	4,476,590	16,581,613	3.3%	5,122,642	4,971,148	17,947,702	0.8%
FE	2,894,896	2,147,363	6,069,081	12.3%	3,134,207	2,771,151	6,697,906	5.4%
GJI	2,510,107	2,034,565	5,767,316	8.2%	2,797,641	2,279,612	6,093,830	8.5%
Sektori	**41,719,891**	**36,499,730**	**141,829,574**	3.7%	**44,719,742**	**42,040,525**	**149,788,076**	**1.8%**




Figura 27. Kthimi në Bazën Rregullatore të Aseteve (BRRA)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak, duke u ulur nga 3.7% në vitin 2024 në 1.8% në vitin 2025.

Në vitin 2025, vetëm 2 nga 7 kompanitë kanë arritur të realizojnë kthim pozitiv në kapital, duke tejkaluar edhe nivelin e planifikuar prej 5.25%. Kjo tregon se këto kompani kanë arritur të mbulojnë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore të përcaktuar në BRRA, brenda kufijve të të hyrave të realizuara.

Performancën më të dobët në normën e kthimit në kapital për vitin 2025, krahasuar me kompanitë e tjera, e ka shënuar KRU "Hidroregjioni Jugor", me -0.2%, duke shënuar një përkeqësim prej 3.8 % krahasuar me vitin 2024. Përkeqësim të normës së kthimit në kapital kanë shënuar edhe KRU "Bifurkacioni", me 6.9%, KRU "Mitrovica", me 2.8%, KRU "Prishtina", me 2.4%, dhe KRU "Gjakova", me 2.5%. Ndërsa përmirësimin më të lartë në raport me vitin 2024 e ka shënuar KRU "Hidrodrini me 5.3%.

[6] Për detaje të mëtejshme mbi bazën rregullatore të aseteve (se si është definuar dhe e përcaktuar) referojuni Udhëzimeve Rregullatore të Kontabilitetit të ARRU.
[7] Të hyrat paraqesin të hyrat nga faturimi i rregullt, të hyrat tjera operative dhe subvencioni.
[8] Shpenzimet paraqesin shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura, mirembajtjen kapitale ujë dhe ujëra të ndotura dhe provizionimin e borgjeve.

3.5.3. Shpenzimet operative

Në këtë pjesë të raportit janë analizuar shpenzimet operative të shtatë (7) ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë, për periudhën dyvjeçare 2024–2025, me fokus në ndryshimin e shpenzimeve të realizuara ndërmjet dy viteve dhe krahasimin e tyre me shpenzimet e planifikuara.

Shpenzimet operative i referohen kostove të KRU-ve të nevojshme për funksionimin, operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura. Në këto shpenzime përfshihen, ndër të tjera, shpenzimet e personelit, energjia elektrike, derivatet, kimikatet, si dhe shpenzimet e tjera administrative dhe operative të lidhura me ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në Tabelën 14 janë paraqitur statistikat e përmbledhura të shpenzimeve operative të planifikuara dhe të realizuara për vitet 2024 dhe 2025, në nivel të sektorit, si dhe në mënyrë të detajuar për secilën KRU. Këto të dhëna mundësojnë vlerësimin e ndryshimeve të shpenzimeve ndërmjet dy viteve, si dhe të nivelit të realizimit të shpenzimeve në raport me planifikimin.


Tabela 14. Vlera e shpenzimeve operative të realizuara dhe planifikuara

Shpenzimet operative	Realizimi		Planifikimi	
KRU	**2024**	**2025**	**2024**	**2025**
PR	13,503,281.34	16,372,675.35	12,097,435.45	12,889,299.00
PZ	4,972,703.95	6,152,597.59	4,885,130.14	4,923,001.17
PE	3,852,279.17	4,193,450.12	3,524,118.00	3,917,136.86
MIT	4,254,878.00	5,101,707.04	3,853,402.91	4,146,731.52
GJA	3,982,480.69	4,794,766.06	4,263,116.73	3,874,937.13
FE	2,212,876.43	2,560,783.09	1,970,390.96	2,350,489.45
GJI	2,074,093.61	2,464,976.00	1,878,888.00	2,421,311.03
Sektori	**34,852,593.18**	**41,640,955.24**	**32,472,482.19**	**34,522,906.16**

Në vitin 2025, për shtatë KRU-të, përmes procesit tarifor janë aprovuar rreth 34.5 milionë euro shpenzime operative, ndërsa shpenzimet e realizuara kanë arritur në 41.6 milionë euro. Kjo nënkupton se niveli i realizimit të shpenzimeve operative ka arritur në 121% të shumës së aprovuar, duke tejkaluar planifikimin për rreth 7.1 milionë euro.

Në krahasim me vitin 2024, shpenzimet operative në vlera nominale janë rritur për rreth 6.8 milionë euro, ose 19%. Rritja e shpenzimeve është evidentuar në të dy shërbimet, por ka qenë më e theksuar në shërbimin e ujërave të ndotura. Konkretisht, shpenzimet operative për furnizimin me ujë janë rritur për 17%, ndërsa shpenzimet operative për shërbimin e ujërave të ndotura janë rritur për 33%.

